



HAPI 7: PAJISJA ME LETËRNJOFTIM DHE DOKUMENT UDHËTIMI

Me dhënien e vendimit pozitiv, personi me status të dhënë pa shtetësi duhet të caktojë një termin për aplikim për letërnjoftim për qëndrim të përkohshëm pranë Departamentit për të Huajt (adresa e disponueshme më poshtë). Pas përfundimit të të gjitha procedurave administrative, personit do t'i lëshohet letërnjoftimi i përkohshëm i qëndrimit si person pa shtetësi, i vlefshëm për një (1) vit me mundësi vazhdimi.



HAPI 8: APLIKIMI PËR RIPËRTRIRJE TË LETËRNJOFTIMIT NË BAZA VJETORE

Personi të cilit i është dhënë statusi pa shtetësi duhet të paraqesë personalisht kërkesë për ripërtrirje të letërnjoftimit në Divizionin për të Huajt, shtatë (7) ditë pune para skadimit të saj.



HAPI 9: QASJA NË TË DREJTA DHE SHËRBIME SIPAS STATUSIT TË NJOHUR

Pasi të njihet statusi i pa shtetësisë së një individi, ata kanë disa të drejta, duke përfshirë:

- pajiset me dokumente të gjendjes civile me përjashtim të dokumenteve të shtetësisë;
- qëndrojnë në Kosovë për të paktën një (1) vit me leje qëndrim të përkohshëm;
- pajiset me dokument udhëtimi për personat pa shtetësi.

Të drejta të tjera me Rregulloren për Integrimin e të Huajve:

- kujdesit shëndetësor;
- pajisja me dokument identiteti (leje qëndrimi);
- pajisja me dokument udhëtimi;
- arsimimi;
- punësim, vetëpunësim dhe formim profesional;
- qasje në të mira dhe shërbime;
- lirinë e mendimit dhe besimit fetar;
- bashkim familjarë;
- qasje në drejtësi dhe ndihmë juridike falas;
- për të poseduar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;
- fitimin e shtetësisë mbi bazen e natyralizimit.
- të drejta në asocim apo anëtarësim në një organizatë që përfaqëson punëtorët apo punëdhënësit ose në ndonjë organizatë tjetër anëtarët e të cilës janë të përfshirë në një profesion specifik, duke përfshirë përfitimet që rrjedhin nga ato organizata.



KU MUND TË MERRNI NDIHMË FALAS?

Programi për të Drejtat Civile Kosovë (CRP/K) ofron asistencë ligjore profesionale falas për aplikantët për status pa shtetësi që plotësojnë kriteret e personave pa shtetësi, me mbështetjen e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR).

AGJENSIONI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Tel: 038 200 18 941; 038 200 18 950

Emaili: info.anjf@rks-gov.net

Zyra në Prishtinë: Rr. "Zenel Salihu" nr. 30

KONTAKTET

DEPARTAMENTI PËR AZIL, SHTETËSI DHE MIGRACION (DSHAM)

TEL: + 383 38 200 19 596

ADRESA: RRUGA. "LUAN HARADINAJ" N.N

DIVIZIONI PËR TË HUAJT

TEL: +383 38 200 19 027

ADRESA: RRUGA. "LUAN HARADINAJ" N.N

Shtypja e broshurës u mbështet nga Zyra e Shefit të Misionit të Komesariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) në Prishtinë. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNHCR-së.



PROCEDURA E PËRCAKTIMIT TË STATUSIT PA SHTETËSI NË KOSOVË



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

PËRMBAJTJA

" Pa shtetësia i referohet një situatë ku një individ nuk njihet si shtetas nga asnjë shtet sipas ligjeve të tij. Pa shtetësia mund të lindë për arsye të ndryshme, të tilla si ligjet dhe politikat diskriminuese, sfidat administrative në marrjen e dokumentacionit, konfliktet që rezultojnë në zhvendosje dhe boshllëqet në ligjet dhe procedurat e shtetësisë ".
burimi: https://www.unhcr.org/ibelong/wp-content/uploads/1954-Convention-relating-to-the-Status-of-Stateless-Persons_ENG.pdf

PERSONI PA SHTETËSI

Është personi i cili nuk konsiderohet shtetas i asnjë shteti në kuadër të fushëveprimit të ligjeve të tij;

ÇFARË ËSHTË PROCEDURA E PËRCAKTIMIT TË STATUSIT PA SHTETËSI

Procedura e përcaktimit të statusit pa shtetësi është një proces administrativ përmes të cilit një individ mund të aplikojë për një status ligjor si person pa shtetësi.

AUTORITETI PËRGJEGJËS

Autoriteti përgjegjës është Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion – Divizioni i Shtetësisë në kuadër të Ministrisë të Punëve të Brendshme.

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME PSP?

PSP-ja është e rëndësishme pasi që ofron një rrugë ligjore për të marrë statusin ligjor në vendin e vendbanimit për të gjithë personat të cilët nuk mund të dëshmojnë shtetësinë e ndonjë vendi sipas veprimit të ligjeve të tij. Me marrjen e statusit të pa shtetësisë, të gjithë personat e kualifikuar do të kenë qasje në të drejta dhe shërbimet bazë. Në mungesë të identitetit ligjor, personave të cilët nuk ju njihet statusi i personave pa shtetësi mund të jenë në rrezik të shfrytëzimit, diskriminimit si dhe abuzimeve të tjera të të drejtave të njeriut. Të gjithë personat të cilëve u është dhënë statusi pa shtetësi, në pesë vite qëndrim të vazhdueshëm do të kenë të drejtë të aplikojnë për shtetësi nëpërmjet natyralizimit.

KUSH MUND TË APLIKOJ PËR PSP?

Nëse jeni pa shtetësi - nuk keni shtetësi sepse nuk konsideroheni shtetas nga asnjë shtet, keni të drejtë të aplikoni për përcaktimin e statusit pa shtetësi në Kosovë. Kjo vlen për individët të cilëve u mungon dokumentacioni ose provat e duhura për shtetësinë e tyre, si dhe ata që janë pa shtetësi ose kanë një shtetësi të pa përcaktuar për shkak të konflikteve, ndryshimeve në ligjet nacionale ose kufijve territoriale të diskutueshëm.

PROCEDURA PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR STATUSIN E PERSONIT PA SHTETËSI

HAPI 1: MBLEDHJA E PROVAVE

Personi, përpara se të aplikoj për status duhet të siguroj të gjitha dokumentet në dispozicion në lidhje me procedurën dhe kriteret e përcaktimit të statusit të personit pa shtetësi, mënyrën e marrjes së shtetësisë nga personi pa shtetësi dhe personi me status refugjati si:

- *çertifikatë lindjeje ose një dokument tjetër ekuivalent;*
- *dëshmi e lëshuar nga spitali pas lindjes;*
- *dokument udhëtimi (përfshirë edhe ato me afat të skaduar);*
- *çertifikatën e martesës;*
- *dëshmi të shërbimit ushtarak;*
- *dëshmi të shkollës;*
- *dokument identifikimi ose udhëtimi të prindërve, bashkëshortit ose fëmijëve;*
- *dokumentet e imigrimit apo leje e vendbanimit të shtetit të mëhershëm të vendbanimit;*
- *një dokument apo dëshmi të lëshuar nga autoriteti i huaj që vërteton se personi nuk është shtetas i shtetit përkatës;*
- *dëshminë që nuk ka dosje penale lëshuar nga Policia e Kosovës dhe dëshminë që nuk është duke u zhvilluar procedur penale dhe nuk është i dënuar për vepra penale e lëshuar nga Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës;*
- *dokumente të tjera relevante.*

E RËNDËSISHME: Në rast të pamundësisë për të paraqitur dëshmitë e kërkuara më sipër, autoritetet e listuara duhet ex officio të verifikojnë dhe mbledhin informacionin ose provat e nevojshme.

HAPI 2: APLIKIMI

Aplikuesi dorëzon kërkesë me shkrim për përcaktimin e statusit pa shtetësi në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion - Divizioni për Shtetësi (MPB). Aplikacioni përfshin informacionet personale, prejardhja familjare, si dhe arsyet për pa shtetësi. Aplikacionin mund ta gjeni këtu: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=31137>

HAPI 3: Intervista

Aplikuesi do të ftohet për intervistë nga autoritetet për të mbledhur informacion shtesë për të vërtetuar kërkesën për statusin e personit pa shtetësi. Aplikantët do të caktohen për intervista sipas radhës së dorëzimit të kërkesave të tyre dhe këto intervista do të zhvillohen brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e dorëzimit.

HAPI 4: SHQYRTIMI/VLERËSIMI I APLIKACIONIT

Autoritetet do të bëjnë vlerësimin e kërkesës, verifikimin e provave të paraqitura dhe të historisë kriminale me autoritetet e vendbanimit të fundit.

HAPI 5: VENDIMI I SHKALLËS SË PARË:

Divizioni për Shtetësi sjell vendimin me shkrim për bazueshmërinë e aplikimeve, pozitiv apo negativ. Vendimi sjellet brenda afatit prej 180 - 365 ditësh nga dita e aplikimit. Nëse aplikanti përcaktohet se është pa shtetësi, atij do t'i jepet statusi pa shtetësi në Kosovë.

HAPI 6: ANKIMIMI NË SHKALLË TË PARË:

Nëse kërkesa për njohjen e statusit pa shtetësi ose për fitimin e shtetësisë refuzohet, aplikantët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga data zyrtare e marrjes së vendimit. Ankesa duhet të bëhet në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave për Shtetësi pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

ANKIMIMI NË SHKALLË TË DYTË:

Kundër vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Shtetësi në Ministrinë e Punëve të Brendshme, parashtruesi i kërkesës mund të iniciojë konflikt administrativ para gjykatës kompetente sipas Ligjit për Konflikt Administrativ në përputhje me afatin ligjor të paraparë në vendimin e shkallës së dytë administrative.